



Data: 04/09/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C. në Prishtinë, Regjistrimi i Biznesit NUI 812096429, adresa: Rr. Kroi i Bardhë, Qendra Tregtare Dardha, p.n, Prishtinë Republika e Kosovës, përfaqësuar nga z.Fatmir Sejdiu.

Dhe:

Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK), në Prishtinë, Regjistrimi i Biznesit 600595899, adresa: Rr. Luan Haradinaj p.n, përfaqësuar nga z.Avdi Hoti, Nënkryetar.

Marrëveshja e përfitimeve - Programi i shërbimeve shëndetësore për anëtarësinë e **Sindikates së Policisë së Kosovës (SPK)**

1. Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (MoU) është të përshkruaj termat dhe kushtet në lidhje me marrëveshjen e përfitimeve midis **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)** dhe **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C** për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

2. Përkufizimet

2.1 **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.** i referohet kompanisë ose organizatës që ofron shërbime shëndetësore.

2.2 **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)** i referohet organizatës partnere që anëtarësia e saj pranojnë shërbimet.

2.3 Programi i shërbimeve shëndetësore të punonjësve: I referohet marrëveshjes që u mundëson anëtarësisë së **SPK-së** të marrin shërbime shëndetësore të ofruara nga **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.**

3. Fushëveprimi

3.1 **SPK** njeh vlerën dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.**

3.2 **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.** njeh përfitimet e angazhimit me **SPK** duke ofruar shërbime shëndetësore dhe laboratorike për anëtarësinë e saj.

4. Programi i zbritjes së anëtarësisë së SPK

4.1. Të gjithë anëtarët e SPK-së pasi të dëshmojnë me ID kartelën e Policisë së Kosovës ju aplikohet zbritje 20% në shërbimet laboratorike që kryhen në **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.** (biokimi, dhe hematologji), mjekësi familjare dhe dhënje të terapisë (dhënje infuzioni, dhënje injeksioni, etj) dhe e njëjta zbritje vlen edhe për anëtarët e ngushtë të familjes së punonjësve policor. Këto zbritje aplikohen në të gjitha pikat e Olive Clinic (Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Suharekë dhe Prizren). Në dep. e radiologjisë ofrohet 20% zbritje vetëm në pikën e Olive Clinic në Mitrovicë.

5. Përgjegjësitë e palëve

5.1 Përgjegjësitë e Sindikatës së Policisë së Kosovës (SPK) do ti udhëzoj të gjithë anëtarët e saj, sipas nenit 4 të kësaj kontrate për kryerjen e kontrollave shëndetësore, gjithashtu të njoftoj dhe për zbritjet që janë ofruar nga **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.**

- a) **SPK** do të inkurajoj anëtarët e saj që të përdorin shërbimet dhe të promovojnë ndërgjegjësimin për shërbimet e ofruara nga **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.**
- b) **SPK** do i përcjellë tek anëtarësia e saj të gjitha njoftimet, fushatat dhe pakot e ndryshme që do i dërgohen nga **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.**

5.2 Përgjegjësitë e **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.**

- a) **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.** pranon të respektoj çmimin siç specifikohet më lartë në pikën 4 të kësaj marrëveshje për anëtarësinë e kualifikuar të **Sindikates së Policisë së Kosovës (SPK)**
- b) **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.** do t'i ofrojë mbështetjen dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me pyetjet e pacientëve nga **Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK)**.
- c) **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.** do të trajtojë menjëherë çdo çështje ose shqetësim të ngritur nga anëtarësia e **SPK-së** përmes udhëheqësisë së saj në lidhje me planifikimin e kontrollave shëndetësore dhe shërbimeve shëndetësore laboratorike.

6. Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje fillon dhe është valide nga data **11/09/2024**, dhe është e vlefshme për periudhën **2 vjeçare**, deri në datën **11/09/2026**.

7. Konfidencialiteti

Të dyja palët bien dakord të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni pronësor, të ndjeshëm ose konfidencial të ndarë gjatë rrjedhës së kësaj marrëveshjeje.

8. Përfundimi

1. Palët e kësaj marrëveshjeje duhet të njoftojnë palën tjetër 30 ditë më herët, në rast që nuk dëshirojnë të vazhdojnë këtë marrëveshjeje pas skadimit të saj. Në rast të dështimit për të njoftuar palën tjetër, marrëveshja konsiderohet si e vazhduar në heshtje.
2. Palët e kësaj marrëveshjeje mund të ndërprejnë këtë marrëveshjeje, në rast që marrin informacione të faktuara që pala tjetër nuk po përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Në rast të ndërprerjes së marrëveshjes në mënyrë të njëanshme, palët duhet të përmbushin të gjitha obligimet ndaj palës tjetër, të krijuara deri në ditën e ndërprerjes së marrëveshjes.

9. Ndryshimet

Çdo ndryshim ose modifikim i këtij Memorandumi do të bëhet në dakordim me shkrim dhe do të nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

Marrëveshja e plotë:

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit përbën të gjithë marrëveshjen midis **Sindikatës së Policisë së Kosovës (SPK)** dhe **OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.** dhe zëvendëson çdo diskutim, negociatë ose marrëveshje të mëparshme, qoftë me shkrim apo me gojë, që lidhet me temën në fjalë.

SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS

Emri: Avdi Hoti

Titulli: Nënkyetar

Nënshkrimi: _____

Data: 11/09/2024



OLIVE MEDICAL CENTER L.L.C.

Emri: Fatmir Sejdiu

Titulli: Drejtor

Nënshkrimi: _____

Data: 11/09/2024

